

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN MBROSTAR (NJËSI ADMINISTRATIVE E BASHKISË FIER)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Mbrostari, njësi administrative e bashkisë Fier**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 147, datë 26.10.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 643/9, datë 26.10.2015, i ka rekomanduar z. Armando Subashi, Kryetar i bashkisë Fier, ku përfshihet njësi administrative Mbrostar, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE :

1. Gjetje nga auditimi : Miratimi i buxheteve të Komunës Mbrostar për të 3(tre) vitet objekt auditimi, është bërë jashtë afateve kohore të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32.

1.1. Rekomandim: Bashkia Fier (Njësia administrative Mbrostar) të zbatojë afatet kohore të përcaktuara për të miratur buxhetin në Këshillin Bashkiak në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pa kushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, duke shmangur vonesat e pajustificuara e cënuar shërbimet publike.

Në vijimësi

3. Gjetjet nga auditimi: Gjatë viteve 2011-2012, janë larguar nga puna punonjës të ndryshëm, ndërsa gjykata me vendim të formës së prerë gjatë vitit 2013 dhe 2014, ka vendosur detyrimin e komunës Mbrostar të paguaj **2,387,740 lekë**, veprim që përbën shkelje të disiplinës financiare dhënë kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandimi: Bashkia Fier(Njësia Administrative Mbrostar) të marrë masa, që për largimet e punonjësve nga puna, të zbatojë procedurat ligjore, njëkohësisht të ndjekë zbatimin e zhvillimit të proceseve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Struktura organizative e administratës së ish komunës nuk ka paraqitur efikasitet dhe efektivitet, si e tillë nuk ka funksionuar për ndërtimin e strategjive sektoriale në zhvillimin e komunës. Në strukturën organizative të administratës së komunës për vitet 2013, 2014 dhe 2015 është miratuar Inspektor për ndërtimet me arsim të mesëm të përgjithshëm, ndërsa duhet të ishte inxhinier, arkitekt, gjeodet, gjë e cila do të krijonte mundësi për zhvillimin e territorit dhe do të rrisnin mundësinë e ndërtimeve në komunë. Duke mos tërhequr specialist nga komuna Mbrostar, nuk janë miratuar leje zhvillimi ndërtimi, si dhe nuk janë miratuar leje përdorimi për objektet të cilët janë ndërtuar dhe që duhet të regjistroheshin në ZVRPP Fier .

4.1. Rekomandim: Bashkia Fier (Njësia administrative Mbrostar), në aktivitetin e saj , duke reflektuar ndaj mangësive e shkeljeve të konstatauar në ish komunën Mbrostar, të zbatojë sistemin e marrjes në punë vetëm nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në meritat e secilit dhe mbas marrjes në punë për rekrutimet e reja.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi : Nuk janë zbatuar procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të policisë së komunës, pasi nuk kanë patur arsimin përkatës të përfunduar në Akademinë e Rendit, nuk kanë funksionuar komisionet e posaçme dhe nuk ka kontrata 3-vjeçare, sipas kriterëve të Rregullores Brendshme "TIP" të Policisë të komunale, të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr. 1, datë 17.04.2003, neni 11 dhe 7, “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi” pikat 2 dhe 5, me nenin 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Komunale ”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 .

5.1. Rekomandimi: Bashkia Fier për llogari të Njesisë administrative Mbrostar, të marrë masa për emërimin e punonjësve të policisë me komision të posaçëm dhe të vendoset kriter që konkurrentët të kenë mbaruar Akademinë e Rendit dhe më tej të lidhen kontratat 3-vjeçare.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Mbrostar rezulton se nuk është mbajtur regjistri i aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes, apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, vlera e akumuluar e amortizimit sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 30 dhe të kryhet inventarizimi i tyre .

6.1. Rekomandimi : Zyra e financës të marrë masa që të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e cituara mësipër, duke kryer inventarizimin e tyre.

Brenda muajit Shkurt 2015

7.Gjetje nga auditimi: Komisionit i inventarizimit, megjithëse për periudhën e audituar, janë kryer inventarët përkatës, nuk është *evidentuar* asnjë diferencë, nuk është përpiluar raporti përmbledhës, nuk përcaktohet shkalla e amortizimit të akumuluar, nuk përcaktohet gjendja aktuale e aktivitetit afatgjatë, pra kemi një inventar fiktiv .

7.1. Rekomandimi: Të merren masa, që të kryhet inventarizimi i plotë i aktiveve afatgjata, të krahasohet me gjendjen kontabël dhe pasi të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme si më sipër, bazuar në normat ligjore të amortizimit, të bëjë rakordimin me të dhënat e amortizimit të akumuluar në bilanc, duke përcaktuar dobishmërinë e çdo aktivi dhe llogaritur saktësisht amortizimin për çdo aktiv afatgjatë.

Brenda muajit Dhjetor 2015

8. Gjetjet nga auditimi: Për vitin 2013- 2015, nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë arkëtuar detyrimet e llogaritura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, *për tatimin e tokës* bujqësore në shumën **16,760,015 lekë** nga e cila 7,232,271 lekë për vitin 2013, 7,753,886 lekë për vitin 2014 dhe 1,774.000 lekë për vitin 2014 ,veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Dhe ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave “të ndryshuar me ligjin 181/13, ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”, i ndryshuar .

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave e Tarifave ,të marrë masa për evidentimin e debitorëve kontabilizimin e detyrimeve të pa likuiduara **për taksën e tokës bujqësore** deri më datën 30.06.2015 në vlerën **16,760,015** lekë, të mbartura nga viti 2013(shih aneksin nr.2 në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Brenda muajit Mars 2016

9. Gjetjet nga auditimi: Për vitin 2013- 2015, nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë arkëtuar detyrimet e llogaritura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore *për taksën e ndërtesës, taksën e zënies së hapësirave publike,taksën e pastrimit* etj. në shumën **11,429,443 lekë** , nga e cila në vitin 2013 vlera 2,756,547 lekë për 139 debitor, për vitin 2014 vlera 3,190,085 lekë për 139 debitorë dhe për vitin 2015 vlera 5,482,811 lekë për 165 debitorë.Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ligjin 9632, datë 30,10.2006 “Për sistemin e taksave “të ndryshuar me ligjin 181/13, ligjin 9920, datë 19,05,2008 :Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” të ndryshuar. Nga auditimi i debitorëve të mësipërm, rezultojnë se **17 debitorë janë këshilltar të komunës** dhe paraqiten me detyrime të pa likuiduara në vlerën **956,638 lekë**. Po kështu, gjatë auditimit u konstatua se **66 debitorë për vlerën 2,533,985 lekë**, kanë qenë të punësuar në Komunë .

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Fier (për Njësinë administrative Mbrostar) të marrë masa, për saktësimin e veprimeve kontabël, të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimi e të ardhurave të munguara për vlerën **11,429,443 lekë**, të krijuar nga mos vjelja e *taksës së ndërtesës, taksës së zënies së hapësirave publike, taksës së pastrimit*. Arkëtimi i detyrimeve të fillojë nga ish këshilltarët si dhe debitorët e tjerë.

Brenda muajit Mars 2016

10. Gjetje nga auditimi: Në pozicionin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në bilancet e vitit 2013 dhe 2014, janë paraqitur në kundërshtim me pikën 12. a. të standardit nr. 5, krahas shumave të mëparshme, vlera për shumën **2,069,638 lekë** për projekte të disa rrugëve të

ndërtuara në këtë periudhë, shpenzimi i kryer për këto duhet të ishte kaluar në vlerën e objektit për të cilin ato janë blerë apo hartuar, si element i drejtpërdrejtë i kostos.

10.1. Rekomandimi: Zyra e financës të sistemojë vlerën 2,069,638 lekë duke saktësuar në formatin 6/1 “Gjendja dhe lëvizja e Aktiveve të Qëndrueshme”, me vlerën bruto të tyre.

Brenda muajit Dhjetor 2015

11. Gjetje nga auditimi: Në tenderët e zhvilluar, Titullari i Autoritetit Prokurues nuk ka siguruar ndarjen e detyrave për nëpunësit e përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu V, pika 1/a, 2/a (Nga Janari 2015 i nenit 56, të VKM nr.914, datë 29.12.2014) “Mbi miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, nenet 15, 22 .

11.1 Rekomandim: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Fier, ku përfshihet Njësia administrative Mbrostar, Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë) të sigurojë ndarjen e detyrave për të gjithë nëpunësit e përfshirë, në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit gjatë fazës së zhvillimit të prokurimeve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nuk janë kryer procedurat e nevojshme teknike dhe ligjore, për regjistrimin në ZVRPP Fier e pasurisë së ish Komunës, të pronave të pa luajtshme, të cilat me VKM nr. 662, datë 04.08.2010, kanë kaluar në pronësi të Komunës, si dhe 14 ha Pyje dhe kullora që me VKM nr.678, datë 21.05.2008, kanë kaluar në pronësi të Komunës Mbrostar gjithsej 14 ha ndërkohë që në kundërshtim me kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”, nenit 30 dhe 35/a të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

12.1 .Rekomandim: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Fier, në të cilën përfshihet njësia administrative Mbrostar, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm tekniko ligjor, për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të ish Komunës Mbrostar.

Brenda muajit Mars 2016

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (deri në Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 5,690,972 lekë** .

1. Gjetje nga auditimi: U konstatua se disa ish Këshilltar të komunës, janë paguar padrejtësisht për vlerën **1.535,074, lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015 sipas protokollit të mbledhjes të Këshillit Komunal, në mos përputhje me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ku përcaktohet: ”Këshilltari shpërblehet për punën që kryen .

1.1.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të marrë masa dhe të kryej arkëtimin e vlerës **1,535,074 lekë**, për pagesa të paligjshme, nga këshilltarët.

Brenda datës 31.03.2016

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Mbrostar ka kryer pagesa të pajustificuara për kamatë vonesa të llogaritura dhe gjoba të vendosura DRT Fier në 6 raste për vlerën **109,500 lekë**, sipas urdhër shpenzimit(u.shp) nr,269, datë 12.11.2013, u.shp. nr.160, datë 160, dt.09.05.2014, u. Shpenzimit nr.161, datë 09.05.2014, nr.162, datë 09.05.2014, u.shp. nr. 196. datë 21.05.2014,urdhër shpenzimit nr.62, datë 20.02.2015. Kamatëvonesat e llogaritura dhe gjobat e vendosura kanë të bëjnë me mos likuidim në kohë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos likuidim në kohë të detyrimeve ndaj subjekti ÇEZ, për disa individë, por që janë përballuar nga buxheti i Komunës, pa vendim të Këshillit të Komunës, pa i diskutuar dhe pa nxjerrë përgjegjësinë për

shkaqet dhe shkaktarët, në kundërshtim kjo me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me pikën 102, të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit” .

2.1.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të marrë masa dhe të analizojë në Këshillin Bashkiak këto pagesa dhe pas vendimit të kryhen veprimet përkatëse për sistemimin e vlerës **109,500 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e kësaj vlere.

Brenda datës 31.12.2015

3. Gjetje nga auditimi: Komuna Mbrostar ka kryer pagesa të pajustificuara për përballimin e shpenzimit të energjisë elektrike për individët familjar **J.B, L.D, L. H, Sh.Xh, V. T dhe P.V**, për **vlerën 1,282,488 lekë**, me pretendimin se kjo energji është harxhuar për pompat që kanë shërbyer për mbushjen e puseve me ujë të përdorura nga komuniteti. Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë marrëveshje të lidhur për këtë qëllim, për marrjen me qira të pompave apo puseve nga Komuna dhe për ti përdorur për llogari të furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kontratat me CEZ, janë në emër të personave individ. Organet drejtuese të komunës dhe Zyra e financës, ka vepruar në kundërshtim me pikën 120 e Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Veprimi i mësipërm nuk është në përputhje me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikën 102 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit”. Nga përfituesit e ujit nuk rezulton të jetë paguar tarifë për furnizim me ujë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi : Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë shpërblimin e dëmit në **vlerën 1,282,488 lekë** nga z. *P.V në vlerën 738,398 lekë*, z.*Sh.Xh në vlerën 156,102 lekë*, z.*L.H në vlerën 148,563 lekë*, z. *L.D në vlerën 117,410 lekë* dhe z. *V.T për vlerën 75,000 lekë*.

Brenda datës 31.03.2016

4-Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të përdorimit të karburantit nga mjetet e ish komunës Mbrostar, rezulton se nga përllogaritja jo e saktë e distancës kilometrike Fier -Tiranë dhe Tiranë-Fier, buxhetit të Komunës i është shkaktuar ***një dëm ekonomik në vlerën 330,781 lekë*** .

4.1.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë në rrugët ligjore shpërblimin e dëmit në **vlerën 330,781 lekë**, për z. *T.R në vlerën 85,738 lekë*, z.*A.M në vlerën 148,842 lekë*, z.*E.B në vlerën 53,791 lekë* dhe z. *P.Dh në vlerën 45,410 lekë*.

Brenda datës 31.03.2016

5. Gjetje nga auditimi : Në saj të lëshimit të disa urdhër dorëzimi të pa studiuar dhe të parregullt, për daljet e disa artikujve nga magazina dhe krijimin e vlerës **487,764 lekë dëm ekonomik**, për diferencë të rezultuara nga rakordimi i normativave të përdorimit me sasinë e tërhequr dhe nevojat faktike për artikujt , vaj motori, rripa motori, alkool, graso, goma, gomardare të pa justifikuar. Shpenzimi i pa argumentuar dhe i pa justifikuar, është në kundërshtim me nenin 13, pika c, të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”., me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin” .

5.1. Rekomandimi : Nëpunësi Autorizues të marrë masa dhe të nxjerrë aktet administrative dhe të ndiqen rrugët ligjore, për kërkimin e shpërblimit të dëmit për **8 raste** në vlerën **487,764 lekë** për: *J. Th.: për vlerën 242,103 lekë*, *Q.M në vlerën 68,461 lekë*, *A.M, në vlerën 80,100 lekë* , *E. B në vlerën 4,600 lekë*, *P.Dh në vlerën 22,208 lekë*, *H.Xh, në vlerën 31,771 lekë* dhe *S.Sh në vlerën 7,200 lekë*.

Brenda datës 31.03.2016

6. Gjetje nga auditimi : Sipas komisionit të miratuar, janë propozuar për t’u nxjerrë jashtë përdorimi **6 motoçikleta**(transportues) me vlerë gjithsej **235,800 lekë** .Në fakt llogaria 215 “Mjete Transporti” për vitin 2014, është pakësuar për **310.200 lekë**, ose **74,400 lekë** më shumë se vlera e propozuar nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi. Është vepruar në kundërshtim me pikën 120, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjeve nga përdorimi, njësia e qeverisë vendore, nuk ka informuar Këshillin e komunës për vlerën e **2,556,132 lekë** .

6.1 Rekomandimi : Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin për vlerën për **74,400 lekë**, e pakësuar në postin e llogarisë 215

“Mjete transporti”, të bilancit të vitit 2014, ç`ka ngarkon me z.N.S me detyrë përgjegjëse e zyrës së financës dhe z.A.G si posedues i motoçikletës me vlerë **37,200** lekë sejcili.

Brenda datës 31.03.2016

7.Gjetje nga auditimi : Nëpunësi zbatues i njësisë, nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 102 e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30. datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në lidhje me përcaktimin e gjendjes së e aktiveve. Nuk është hartuar lista e aktiveve që do të vlerësoheshin e cila nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tri kopje, një nga të cilat qëndron në zyrën e financës. Nuk janë respektuar kërkesat për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve publike të parashikuar në paragrafët 107, 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Në fletë daljet e prera për nxjerrjet jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre janë përfshirë edhe një raft hekuri (faqe muri) me vlerë 16,000 lekë. Bazuar në vlerën fillestare të kontabilizuar, zbritur 70-80% amortizim, rezulton një diferencë vlerë për **6,800 lekë** e që mbetet në përgjegjësi të komisionit .

7.1. Rekomandimi : Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë arkëtimin e detyrimit nga personat përgjegjës,përkatësisht: **znj. N.S për vlerën 1700 lekë, R. K për vlerën 1700 lekë, F.G për vlerën 1700 lekë dhe S.L për vlerën 1700 lekë.**

Brenda muajit Nëntor 2016

8. Gjetje nga auditimi: Ish komuna Mbrostar si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **894,878 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “J...” sh.p.k. dhe “Z.... K” sh.p.k. në situacionimin e volumeve të punimeve për 2 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera dhe llogaritje të gabuar të çmimit/njësi në objektin “Ngritje Terreni sportiv Fshati Petrovë”, Komuna Mbrostar, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 609/16, datë 1.10.2014

8.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **894,878 lekë**, nga bashkimit i operatorëve ekonomik “J.....” sh.p.k. dhe “Z....”, paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Ngritje Terreni sportiv fshati Petrovë”.

Brenda datës 31.01. 2016

9. Gjetje nga auditimi:: Ish komuna Mbrostar si Autoriteti Kontraktor, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **106,950 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “B....” sh.p.k. dhe “N.... ” shpk. , në situacionimin e volumeve të punimeve për 2 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera dhe llogaritje të gabuar të çmimit/njësi në objektin “Shpim pusi uji Petrova 13, për furnizim me ujë”, Komuna Mbrostar, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 249/12, datë 17.06.2013.

9.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Komuna Mbrostar, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **106,950 lekë**, nga bashkimit i operatorëve ekonomik “B.....” sh.p.k. dhe “N.....”, paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Shpim pusi uji Petrova 13, për furnizim me ujë”.

Brenda datës 31.03. 2016

10. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Vajkan”, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier.Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **288,360 lekë pa TVSH** si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

10.1. Rekomandim: Nga Komuna Mbrostar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **288,360 lekë** me TVSH nga nga operatori ekonomik “B.....” Shpk & “S & L...” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 867/20 prot, datë 30.12.2014 me objekt: “Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Vajkan”, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.03. 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i linjës së ujësjiellësit Verri-Kallm i Madh”, për vitin 2015 Komuna Mbrostar, Rrethi Fier. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **165,750 lekë** pa TVSH, si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar .

11.1. Rekomandim: Nga Komuna Mbrostar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **165,750 lekë pa TVSH** nga nga operatori ekonomik “A....” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 401/15 prot, datë 25.06.2015 me objekt: “Rikonstruksioni i linjës së ujësjellësit Verri-Kallm i Madh”, për vitin 2015 Komuna Mbrostar, Rrethi Fier, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.01. 2016

12. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujësjellësit fshati Verri”,për vitin 2015, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **94,750 lekë** paTVSH si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar .

12.1. Rekomandim: Nga Komuna Mbrostar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **94,750 lekë** pa TVSH “Z.....” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 389/18 prot, datë 03.06.2015 me objekt: “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujësjellësit fshati Verri”,për vitin 2015, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12. 2015

13. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujit të pijshëm Vajkan”,për vitin 2014, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **107,004 lekë**, pa TVSH si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

13.1. Rekomandim: Nga Komuna Mbrostar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **107,004 lekë** pa TVSH nga operatori ekonomik “B.....” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 302/13 prot, datë 03.06.2014 me objekt: “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujit të pijshëm Vajkan”,për vitin 2014, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.01. 2016

14.Gjetje nga auditimi : Në kundërshtim me pikën me neni 20 të kontratës së furnizimit me nr.123/12 prot, lidhur në datën 18.4.2014, ndërmjet Komunës Mbrostar Fier, dhe kontraktorit shoqërisë “AGA 1” sh.p.k. me vlerë totale pa TVSH 3,600,000 lekë, çmimin e Gazoilit D1 180 lekë/litër me TVSH (marzhi i fitimit 3.33% ose 3.33lekë /litër) është lidhur kontrata me objekt: “Shtesë për nevojat e fillim vitit 2104 për blerje karburanti”. Çmimi i kontratës shtesë është 10 lekë/litër më i lartë se kontrata bazë , veprim i pa justifikuar i komisionit të negociimit të ofertës në kundërshti me neni 20 të kontratës e efekt financiar **45,473 lekë pa tvsh** .

14.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fier ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **45,473 lekë** nga punonjësit: *E.L në vlerën 11,368 lekë, B.Dh në vlerën 11,368 lekë, N. S në vlerën 11,368 lekë, L. Ç në vlerën 11,368 lekë.*

Brenda datës 31.01.2016

C. MASA DISIPLINORE:

I. Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a “*llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 8 të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr.

8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, **kërkojmë** kryetarit të Bashkisë Fier, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

I. Znj. N.K me detyrë përgjegjës i sektorit financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

-për pagesën e disa koshilltarëve komunalit për vlerën **1.535,074, lekë shume e cila përbën** dëm ekonomik, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015 , në kundërshtim dhe mospërputhje me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Këshilltari shpërblehet për punën që kryen”.

-për pagesa të pajustificuara për përballimi e shpenzimit të energjisë elektrike për individët familjar për vlerën **1,282,488 lekë**, me pretendimin se kjo energji është harxhuar për pompat që kanë shërbyer për mbushjen e puseve me ujë. Veprimi i kryer është në kundërshtim me pikën 10 të Kapitullit “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publik”. Veprimi i mësipërm nuk është në përputhje me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me pikën 102, të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit”. Nga përfituesit e ujit nuk rezulton të jetë paguar tarifë për furnizim me ujë.

- Për pagesë të pajustificuara për kamatëvonesa të llogaritura dhe gjoba të vendosura DRT Fie, në 6 raste për vlerën **109,500 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr.269, datë 12.11.2013, u.shp. nr.160, datë 160, dt.09.05.2014, u. Shpenzimit nr.161, datë 09.05.2014, nr.162, datë 09.05.2014, urdhër shpenzimit nr. 196. datë 21.05.2014, urdhër shpenzimit nr.62, datë 20.02.2015. Kamatëvonesat e llogaritura dhe gjobat e vendosura kanë të bëjnë me mos likuidim në kohë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos likuidim në kohë të detyrimeve ndaj Subjekti ÇEZ, për disa individë, por që janë përballuar nga Buxheti i Komunës , pa vendim të Këshillit të Komunës, pa i diskutuar dhe pa nxjerrë përgjegjësisë për shkaqet dhe shkaktarët, në kundërshtim kjo me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me pikën 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit”.

-gjatë auditimit të përdorimit të karburantit nga mjete e Komunës Mbrostar rezulton se nga përlllogaritja jo e saktë e distancës kilometrike Fier -Tiranë dhe Tiranë Fier buxhetit të Komunës i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **330,781 lekë**.

- për lëshimit të disa urdhër dorëzimi të pa studiuar dhe të parregullt për daljet e disa artikujve nga magazina dhe krijimin e vlerës **487,764 lekë** dëm ekonomik, për diferenca të rezultuara nga rakordimi i normativave të përdorimit me sasinë e tërhequr dhe nevojat faktike për artikujt , vaj motori, rripa motori, alkool, graso, goma, gomardare të pa justifikuar; për vitin 2013, 2014 dhe 2015. Shpenzimi i pa argumentuar dhe i pa justifikuar që rezulton në shumën e mësipërme bie ndesh me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, çka ngarkon me përgjegjësi autorizuesit e shpenzimit , marrësit e artikujve sipas fletëdaljeve përkatëse . -Në kundërshtim me pikën 120 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjeve nga përdorimi, përgjegjësia e financës ka pakësuar llogaria 215 “Mjetet transporti” për vlerën e **74,400 lekë** (një motoçikletë) pa informuar më parë Këshillin e Komunës si dhe artikujt inventar ekonomik për vlerën e **2,556,132 lekë**.

-nuk ka zbatuar kërkesën e pikës 102 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30. datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në lidhje me përcaktimin e gjendjes së aktiveve.

-nuk ka hartuar listën e aktiveve që do të vlerësoheshin e cila nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tri kopje, një nga të cilat qëndron në. Nuk janë respektuar kërkesat për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të parashikuar në paragrafët 107, 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

-në fletë daljet e prera për nxjerrjet jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre janë përfshirë edhe një raft hekuri (faqe muri) me vlerë 16,000 lekë. Nuk vërtetohet që hekuri është gëpusur, ai duhet të peshohet , të vlerësohet dhe të shitej qoftë edhe si mbeturinë.

-për parregullsi në kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2013, përkatësisht për mjete e transportit(motoçikleta), për mos zbatimin e kërkesave në lidhje me vlerësimin e materialeve për nxjerrje jashtëpërdorimi dhe asgjësimin e tyre në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “.

-për mos pasqyrimin në kontabilitet dhe mosndjekjen në vazhdimësi të detyrimeve të krijuar nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore

-Për mos sistemimin në bilancin e vitit 2013 dhe 2014 në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” sipas objekteve përkatëse ku është kryer investimi, por vazhdojnë të mbahen gjendje në llogarinë 202 “investime për studime projekte e kërkime shkencore” në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2. K.L me detyrë Përgjegjës i zyrës së Taksave dhe tarifave vendore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mosrealizim të ardhurave të taksave vendore 53.8 % , për vitin 2014, për 26 % po kaq edhe për 6/mujorin e parq të vitit 2015 .

- Për mos koordinimin e punës me zyrën e financës e përpunuesit për vitin 2013-2014 dhe 2015, nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë arkëtuar detyrimet e llogaritura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore për tatimin e tokës bujqësore në shumën 16,760,015 lekë nga e cila 7,232,271 lekë për vitin 2013, 7,753,886 lekë për vitin 2014 dhe 1,774.000 lekë për vitin 2014 ,veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Dhe ligjin 9632, datë 30,10.2006 “Për sistemin e taksave “të ndryshuar me ligjin 181/13, ligjin 9920, datë 19,05,2008 :Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar.

-Për mos arkëtimin e detyrimeve të llogaritura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksën e ndërtesës, taksën e zënies së hapësirave publike,taksën e pastrimit etj. në shumën **11,429,443 lekë**, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ligjin 9632, datë 30,10.2006 “Për sistemin e taksave “të ndryshuar me ligjin 181/13, ligjin 9920, datë 19,05,2008 :Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” të ndryshuar. Nga auditimi i debitorëve të mësipërm, rezultojnë se 17 debitorë janë këshilltar të komunës dhe paraqiten me detyrime të pa likuiduara në vlerën 956,638 lekë. Po kështu gjatë auditimit u konstatua se **66 debitorë për vlerën 2,533,985 lekë**, kanë qenë të punësuar në Komunë.

Nga Bashkia Fier(për llogari të ish komunës Mbrostar,) ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Shehu, Genc Koka, Abdulla Duka, Luan Kuka dhe Taulant Dërvishi, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

